

Ministria e Arsimit dhe Sportit  
Instituti i Zhvillimit të Arsimit

**DRAFT - PROGRAMI I NJOHURISE PER SHOQERI**

## **PËRMBAJTJA E PROGRAMIT:**

### **1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”**

#### **1.1. Hyrje në programin e qytetarisë**

### **2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT**

#### **2.1. Qëllimet e programit të qytetarisë**

#### **2.2. Lidhja e kompetencave të lëndës me kompetencat e tjera kyç.**

#### **2.3. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare**

#### **2.4. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të nxënit**

#### **2.5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj**

#### **2.6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë**

### **3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN 1, 3**

### **4. UDHËZIME METODOLOGJIKE**

### **5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN**

### **6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE**

## **1. FUSHA “SHOQËRIA DHE MJEDISI”**

Arsimi parauniversitar krijon kushte dhe mundësi që nxënësi: të ndërtojë dhe të zhvillojë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që kërkon shoqëria demokratike; të zhvillohet në mënyrë të pavarur e të gjithanshme; të kontribuojë në ndërtimin dhe mirëqenien vetjake dhe të shoqërisë shqiptare dhe të përballet në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës.

Në arsimin parauniversitar nxënësi:

- Kultivon identitetin vetjak, kombëtar dhe përkatësinë kulturore;
- përvetëson vlera të përgjithshme kulturore dhe qytetare;
- zhvillohet në aspektet intelektuale, etike, fizike, sociale dhe estetike;
- zhvillojnë përgjegjësi ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit;
- aftësohet për jetë dhe për punë, në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore;
- aftësohet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- zhvillon shpirtin e sipërmarrjes;
- përdor teknologjitë e reja.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” i krijon nxënësit mundësitë të zhvillojë kompetencat e nevojshme për të përmbushur rolin e tij si anëtar i një shoqërie shumëkulturore dhe demokratike, në një botë gjithnjë e më të ndërvarur. Kompleksiteti i botës shoqërore sot po

rritet, për shkak se shoqëritë janë në një proces të vazhdueshëm ndryshimi dhe lidhjesh globale, shoqëruar me rritje të lartë të lëvizshmërisë së popullsisë, shumëfishim të kontakteve midis kulturave të ndryshme, qarkullim të shpejtë të informacionit dhe rritje e globalizimit të ekonomisë. Lëndët që përbëjnë fushën “Shoqëria dhe mjedisi” zhvillojnë te nxënësi të menduarin kritik e krijues, pasurojnë kulturën e tyre dhe i përgatisin të luajnë një rol aktiv në një shoqëri demokratike. Ato nxisin zhvillimin intelektual të nxënësit duke i dhënë mekanizmat konceptual dhe metodologjikë, të cilët nxënësi mund t’i përdorë në situata të ndryshme, e ndihmojnë të prezantojë botën dhe të përballojë situata të ndryshme në jetën e tij.

Fusha “Shoqëria dhe mjedisi” integron njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera nëpërmjet lëndëve Qytetari (Njohuri për shoqërinë - klasa K-2), Histori, Gjeografi. Secila prej tyre e trajton botën dhe shoqërinë nga këndvështrime të ndryshme. Përmes kësaj fushe, nxënësi zhvillon bazat e qytetarisë duke siguruar kuptimin e ligjshmërisë, të proceseve ekonomike, shoqërore, kulturore dhe të çështjeve që lidhen me to; zhvillon konceptin e kohës, të vazhdimësisë dhe të ndryshimit në këndvështrimin e marrëdhënieve historike dhe zbaton këtë kuptim në analizën e pasojave të veprimeve individuale dhe kolektive në shoqëri, në të kaluarën dhe sot; zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, për kompleksitetin dhe ndërvarësinë e vendeve dhe rajoneve në botë. Nxënësi aftësohet të vlerësojë pasojat e ndërveprimit të shoqërisë me mjedisin, për të ndërmarrë veprime që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm.

Programet e lëndëve Njohuri për shoqërinë, Qytetaria, Gjeografia dhe Historia janë ngushtësisht të lidhura nga kompetencat që ato synojnë të zhvillojnë te nxënësi. Përvojat mësimore të kësaj fushe të nxëni në këtë shkallë i shërbejnë përmbushjes së kompetencave kyç, me fokus të veçantë kultivimin e identitetit personal, shoqëror, kombëtar e kulturor.

## 1.1 HYRJE NË PROGRAMIN E LËNDËS QYTETARI (NJOHURI PËR SHOQËRINË – klasa K-2)

Qytetaria demokratike bazohet në parimet themelore të të drejtave të njeriut, të demokracisë pluraliste dhe shtetit të së drejtës. Ajo lidhet, para së gjithash, me të drejtat dhe përgjegjësitë, fuqizimin qytetar, pjesëmarrjen dhe përkatësinë, respektin për diversitetin. Si i tillë ajo përfshin të gjitha grupet shoqërore dhe sektorët e shoqërisë.

Qytetaria demokratike bazohet në një metodë shumëpërmasore, që ka në bazë procesin dhe përfshin:

- ⇒ **Përmasën politike**, pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimit dhe në ushtrimin e pushtetit politik.
- ⇒ **Përmasën ligjore**, vetëdija dhe ushtrimi i të drejtave dhe përgjegjësi të qytetarëve.
- ⇒ **Përmasën kulturore**, respekti për të gjithë njerëzit, vlerat themelore demokratike, për historinë dhe trashëgiminë e përbashkët dhe njëkohësisht të ndryshme, si dhe ndihma për vendosjen e marrëdhënieve ndërkulturore paqësore.
- ⇒ **Përmasën shoqërore dhe ekonomike**, veçanërisht përpjekjet kundër varfërisë dhe përjashtimit social, përpjekjet për krijimin e formave të reja të punës dhe të zhvillimit të komuniteteve dhe si ekonomia të mund të ndihmojë krijimin e një shoqërie demokratike.
- ⇒ **Përmasa evropiane**, vetëdija për unitetin dhe diversitetin e kulturës evropiane dhe të mësuarit për të jetuar në një kontekst evropian.
- ⇒ **Përmasën globale**, njohja, pranimi dhe nxitja e ndërvarësisë dhe të solidaritetit global.

Programi lëndor rrjedh nga Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar, Kurrikula bërthamë dhe Plani Mësimor i Arsimit Bazë.

Si i tillë ky dokument i shërben:

- **Nxënësit** për zhvillimin e kompetencave të qytetarisë, në mënyrë që ai të përballojë sfidat e jetës dhe të integrohen në shoqëri.
- **Mësuesit** për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e veprimtarive mësimore dhe arritjeve të nxënësve në klasë dhe jashtë saj.
- **Prindit** për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe kritereve të vlerësimit.
- **Hartuesit** të teksteve mësimore dhe të materialeve ndihmëse për mësuesit dhe nxënësit.

Zbatimi i programit bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

## **2. KORNIZA KONCEPTUALE E PROGRAMIT**

Programi i lëndës Qytetaria (Njohuri për shoqërinë në klasën K-2) në arsimin bazë është hartuar me një strukturë dhe mënyrë të re konceptimi në funksion të qasjes kurrikulare me bazë kompetencat.

- Ky program krijon kushtet për ndërtimin e kompetencave kyçe të nxënit gjatë gjithë jetës në fushën e qytetarisë demokratike. Kompetencat e synuara përmes në këtë program lidhen me kompetencat e tjera kyçe. Lidhja mes rezultateve të nxënit të kompetencave të lëndës së qytetarisë dhe, kur është e mundur, të kompetencave të tjera kyçe siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor. Procesi i të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus të veçantë zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare.
- Kompetencat zhvillohen përmes tematikave të përbashkëta të fushës dhe në program zërthehen në njohuri, aftësi/shkathtësi, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishëm të programit të lëndës së qytetarisë, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Programi i gjeografisë për këtë shkallë të kurrikulës është i strukturuar rreth dy tematikave të mëdha. Për secilën prej tyre përcaktohen rezultatet e pritshme të shprehur në terma njohurish, shkathtësish dhe qëndrimesh. Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe nuk përmbushen jashtë tematikave, ato janë marrë në konsideratë në të gjithë procesin e hartimit të rezultateve të të nxënit për tematikë, duke qenë pjesë integrale e tyre.
- Strukturimi dhe organizimi i programit për shkallë kurrikule synon ta bëjë këtë program më fleksibël, duke i ndihmuar dhe lënë dorë më të lirë mësuesve për ta zbatuar atë në mënyrë krijuese, si dhe të respektojnë ritmet individuale të nxënësve drejt zotërimit të kompetencave të detajuara në çdo shkallë të kurrikulës.

- Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetencë ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e situatave të të nxënit dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyçe. Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit e i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.
- Konceptimi i kurrikulës me bazë kompetencat krijon mundësitë dhe kërkon zbatimin e integruar të saj. Programi i lëndës së Qytetarisë krijon mundësi integrimi brenda fushës dhe me fushat e tjera, si shkencat e natyrës, matematikën, gjuhën, artet, etj. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare. Ato shërbejnë si çështje kyçe për zhvillimin e kompetencave, integrojnë fushat e të nxënit dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme.
- Programi sugjeron metoda, teknika, strategji të mësimdhënies e të nxënies që nxisin interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësve. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit të tyre.
- Vlerësimi si pjesë integrale e procesit të të nxënit, mat shkallën në të cilën kompetencat janë arritur nga nxënësit. Vlerësimi merr shumë forma, të cilat i parashikon dhe mundëson struktura dhe konceptimi i programit.

## 2.1. Qëllimet e programit të lëndës së qytetarisë

Edukimi për qytetari demokratike **synon**:


- ⇒ të përgatisë të rinjtë dhe të rriturit për pjesëmarrje aktive në shoqërinë demokratike, duke fuqizuar kështu kulturën demokratike;
- ⇒ të aftësojë të rinjtë në luftën kundër ksenofobisë, dhunës, racizmit, nacionalizmit agresiv dhe intolerancës;
- ⇒ të sigurojë dhe të forcojë kohezionin shoqëror, drejtësinë sociale dhe në të mirën e përgjithshme;
- ⇒ të fuqizojë shoqërinë civile përmes pajisjes së qytetarëve me njohuri dhe shprehje demokratike;

Mbështetur në këto qëllime të përgjithshme, programi i **lëndës së qytetarisë synon:**

- T'u japë nxënësve mundësinë të për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë intelektuale, të domosdoshme për të kuptuar, për të analizuar dhe për të ndikuar në politikat sociale dhe mënyrat e zbatimit të tyre.
- T'u japë nxënësve mundësinë të për të zhvilluar aftësitë e pjesëmarrjes qytetare të nxënësve dhe përfshirjen e tyre të vetëdijshme dhe të kualifikuar në zgjidhjen e problemeve të komunitetit.
- T'u japë nxënësve mundësinë të të zhvillojnë përkushtimin qytetar në respektimin e vlerave dhe parimeve demokratike të domosdoshme për bashkëjetesë në një shoqëri demokratike.



**Diagrama 1: Korniza konceptuale e programit**



## **2.2. Lidhja e kompetencave të fushës /lëndës me kompetencat e tjera kyçe**

Ndërtimi dhe zbatimi i kompetencave kyçe nga nxënësi gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies, kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen me kompetencave e tjera kyçe. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat, dhe mjetet e përshtatshme të procesit të nxënies.

### **Kompetenca qytetare**

*Programi i qytetarisë, si pjesë e fushës Shoqëria dhe mjedisi, përmes kërkimit krijon kushte në mënyrë të veçantë për ndërtimin dhe demonstrimin nga nxënësi të kompetencës qytetare.*

Ky program kontribuon edhe në zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe. Rezultatet e të nxënies të synuara nga programi i lëndës qytetaria nxisin, në shkallë të ndryshme, edhe zhvillimin e kompetencave të tjera kyçe.

### **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit**

Programi i *qytetarisë* krijon mundësi për zhvillimin e shkathtësive komunikuese. Nxënësi përdor materiale të printuara, vizuale dhe digjitale, për të eksploruar dukuritë, proceset shoqërore, politike, ekonomike, kulturore etj, në kohë dhe në hapësirë. Ai mëson si të vlerësojë këto burime dhe kuptojë si gjuha mund të përdoret për të zhvilluar më tej të nxënies. Përmes diskutimeve, lojës në role, debateve, prezantimeve etj, nxënësi zhvillon shkathtësi të të shprehurit; në mënyrë progresive ai zhvillon dhe përdor fjalorin e përshtatshëm për të komunikuar idetë, informacionet etj. në mjedise dhe për audiencë të ndryshme.

### **Kompetenca e të menduarit**

Nxënësi zhvillon të menduarin kritik dhe krijues gjatë vlerësimit të të dhënave dhe përdorimit të tyre, teston shpjegimet dhe peshon argumentet. Ai zhvillon shkathtësitë për marrjen e vendimeve dhe strategjitë që e ndihmojnë të mendojë në mënyrë analitike

dhe logjike. Programi mundëson që nxënësi të kuptojë vlerën dhe procesin e drejtimit të pyetjeve, të jetë krijues dhe të zhvillojë imagjinatën në vëzhgimet që bën në terren.

Programi i *qytetarisë* nxit përdorimin e matematikës dhe të mendimit matematik për interpretimin e të dhënave etj.

### **Kompetenca e të nxënit**

Për të mbështetur edukimin për qytetari demokratike, nxënësi shfrytëzon informacionin nga burime të ndryshme, gjykon vlefshmërinë dhe rëndësinë e tij. Në procesin e kërkimit, ai përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimit për përgatitjen e prezantimeve të tij dhe komunikimin e gjetjeve.

Nxënësi mendon në mënyrë kritike kur shqyrton pasojat e veprimtarisë njerëzore në një mjedis të caktuar, kur vlerëson zgjidhjet e problemeve globale, kur krijon dhe mbron qëndrimin e tij.

Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme shoqërore e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë, përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim. Në procesin e realizimit të detyrave demonstroi respekt dhe mirëkuptim, pranon mendimet ndryshe. Përdor gjuhën e politikës, të ligjit, të moralit, të ekonomisë për të komunikuar mendimet dhe idetë e tij dhe për të organizuar përgjigjet.

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin**

Nxënësit zgjidhin çështje të ndryshme që lidhen me mjedisin shoqëror, ekonomik, ligjor, kulturor etj., me kompleksitetin e dukurive të tij, vlerëson rëndësinë dhe efektivitetin e zgjidhjeve të propozuara nga njëri-tjetri. Ndërgjegjësimi për dukuritë e ndryshme e ndihmon nxënësin të njohë kulturën e tij dhe kulturat e tjera. Nxënësi mëson të bashkëpunojë ndërsa përballet me detyra komplekse që kërkojnë bashkëpunim.

### **Kompetenca personale**

Programi i qytetarisë nxit të nxënit e bazuar në kërkim, duke zhvilluar aftësinë e nxënësve për të menaxhuar veten. Nxënësi kupton rolin e tyre në procesin e të nxënit dhe në kryerjen e hetimeve, aftësohen të jenë të pavarur në zbatimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe në marrjen e vendimeve. Përmes punës në bashkëpunim në klasë dhe në terren, nxënësit zhvillojnë aftësitë ndërpersonale dhe mësojnë të vlerësojnë perspektivat e ndryshme të anëtarëve të tjerë të grupit.

### **Kompetenca digjitale**

Nxënësi zhvillon kompetencën digjitale përmes përdorimit të TIK-ut në mënyrë efektive dhe të përshtatshme kur kërkon, krijon, përpunon, komunikon idetë dhe informacionin për dukuritë shoqërore, politike, kulturore etj.

## Diagrama 2: Rezultatet e të nxënit të kompetencave kyçe që realizohen nëpërmjet lëndës së qytetarisë

### **Kompetenca e komunikimit dhe të shprehurit** (*Nxënësi komunikon në mënyrë efektive*)

- Shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në forma të tjera të komunikimit.
- Dëgjon me vëmendje prezantimin dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime.
- Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm.
- Veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose detyrë me shkrim.

### **Kompetenca e të menduarit** (*Nxënësi mendon në mënyrë kritike dhe krijuese*)

- Parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në medie.
- Zgjidh një problem (shoqëror, shkencor...etj) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse.
- Përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (shkencor, shoqëror).
- Shpjegon mënyrën e zhvillimit të një procesi natyror ose shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë.
- Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore,

natyrore.

- Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore.

### **Kompetenca e të nxënit** (*Nxënësi mëson për të nxënë*)

- Përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
- Shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë shoqërore, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit.
- Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
- Ndërlidh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake, duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike.
- Parashtron pyetje (pse, çfarë, si, kur?) dhe organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/ problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur.
- Menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo në terren).

### **Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin** (*Nxënësi kontribuon në mënyrë produktive*)

- Zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin.

- Diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre.
- Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

### **Kompetenca personale** *(Nxënësi bën jetë të shëndetshme)*

- Vlerëson shkaqet e një situatë të mundshme konflikti midis moshatarëve ose anëtarëve të grupit dhe propozon alternativa për parandalimin dhe zgjidhjen, duke ndarë përvojat dhe mendimet në grup.

### **Kompetenca qytetare** *(Nxënësi përkushtohet ndaj të mirës së përbashkët)*

- Tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerren pa dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/komunitetit.
- Merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

### **Kompetenca digjitale** *(Nxënësi përdor teknologjinë për të nxitur inovacionin)*

- Përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë për zhvillimin e njohurive.
- Analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik).

### **2.3. Lidhja e lëndës së qytetarisë me temat ndërkurrikulare**

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria. Ato i shërbejnë zhvillimit të kompetencave dhe synojnë të ndihmojnë nxënësin të lidhë shkollimin e tij me jetën e përditshme. Në shumë aspekte, programi i lëndës së qytetarisë fokusohet në zhvillimin e temave të mëdha ndërkurrikulare, si:

- Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave
- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Mjedisi
- Ndërvarësia
- Bashkëjetesa paqësore

Duke analizuar marrëdhëniet e shoqërisë në këndvështrimin e përgjegjësive qytetare, nxënësi mëson të vendosë lidhje ndërmjet nevojave dhe përdorimit racional të burimeve. Ai ndërgjegjësohet për aspektet shoqërore të konsumit, për pasojat e globalizmit për shoqërinë dhe shpërndarjen e burimeve. Ky ndërgjegjësim e ndihmon nxënësin të kuptojë më mirë ndërvarësinë e ndërsjellë të mjedisit dhe të veprimtaria njerëzore. Në këtë mënyrë, programi ndihmon për edukimin për Zhvillimin e qëndrueshëm dhe Mjedisin. Përmes studimit të vendeve dhe rajoneve të ndryshme, transferimit të të nxënit në vendin e tij, nxënësi ndërgjegjësohet për rolin e tij si qytetar. Kjo e ndihmon atë të jetë mendje hapur dhe të respektojë diversitetin. Nxënësi ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, ndërvarësinë e njerëzve, konfliktet ndërkombëtare, dhe nevojën për të zhvilluar kulturën e paqes. Në këtë mënyrë ai jo vetëm kupton domethënien e veprimeve njerëzore në një vend të caktuar, por zgjedh qëndrimin e tij për çështjet globale. Programi kontribuon për edukimin e identitetit kombëtar, njohjen e kulturave, ndërvarësinë dhe bashkëjetesën paqësore.

### **2.4. Lidhjet e lëndës së qytetarisë brenda fushës dhe me fushat e tjera të të nxënit**



Lënda e qytetarisë (Njohuri për shoqërinë klasa k-2) duhet të zhvillohet në lidhje të ngushtë me lëndët e tjera. Lënda e qytetarisë dhe lëndët e tjera duhet të ndihmojnë në mënyrë të ndërsjellë njëra-tjetrën. Vetëm në këtë mënyrë do të mund të realizohen si duhet edhe objektivat kryesorë të shkollës dhe të shoqërisë në fushën e arsimit.

Çfarë do të thotë kjo?

- Së pari, Lënda e qytetarisë mund të shfrytëzojë informacionin dhe çështjet që trajtohen në lëndët e tjera për të sqaruar, për të konkretizuar dhe për të argumentuar më mirë idetë e veta.
- Së dyti, lëndët e tjera duhet të shfrytëzojnë përmasën dhe këndvështrimin qytetar për të aktualizuar dhe për të kuptuar më mirë çështjet e tyre në diskutim, si dhe për të nxitur përgjegjësinë dhe motivimin qytetar të nxënësve në shkollë dhe në bashkësinë ku jetojnë

## **Shembuj**

### **I. Historia dhe qytetaria**

Lënda e historisë dhe ajo e qytetarisë kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** për shembull pushteti, autoriteti, ligji, qeverisja, përfaqësimi, liria, etj.
- **Aftësitë dhe shprehjet:** për shembull përshkrimi, analiza, shpjegimi, diskutimi, kërkimi, interpretimi etj

### **Qytetaria:**

- u jep aktualitet më të madh çështjeve me të cilat merret historia. Në këtë mënyrë, ajo i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e historisë për jetën e tyre të përditshme.

Si mund të realizohet lidhja ndërmjet lëndës së historisë dhe qytetarisë?

1. Së pari kjo lidhje mund të realizohet përmes përfshirjes të çështjeve, të fakteve, të ngjarjeve etj. të trajtuar në lëndën e historisë në kurrikulën e qytetarisë me kusht që përmasa e qytetarisë duhet:

- Të jetë çështja thelbësore e mësimit;
- Të lidhet me kurrikulën e qytetarisë.

2. Së dyti, objektivat mësimorë duhet të shprehen qartë dhe të jenë pjesë e kurrikulës kombëtare të qytetarisë. Kështu, lidhja ndërmjet tyre mund të realizohet përmes elementeve të mëposhtëm:

- **Konceptet:** Karakteristikat e koncepteve (si drejtësia, barazia, liria etj) duhet të shpjegohen në kohë dhe në hapësirë, pra në kontekste konkrete historike, në të kaluarën dhe në të sotmen.
- **Tema:** Në disa mësimë mund të theksohet përmasa e qytetarisë, si për shembull, në çështjet e të drejtave të njeriut.
- **Fusha kurrikulare:** Rishqyrtimi i vazhdueshëm i çështjeve të tilla si demokracia etj., gjatë gjithë ciklit të shkollimit.
- **Përmasa vendore:** historia duhet të ndihmojë në rritjen e pjesëmarrjes qytetare në jetën e bashkësisë, për shembull, duke ndërmarrë projekte ku mund të përfshihen breza të ndryshëm.

3. Së treti, historia ndihmon në edukimin qytetar kur ajo përdoret në debatet për çështje dhe ngjarje të rëndësishme

## II. Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe qytetaria

1. Çfarë kanë të përbashkët Gjeografia (Dituria e natyrës) dhe qytetaria? Ato kanë të përbashkët:

- **Konceptet:** të drejtat e njeriut, bashkësia, ndërvarësia etj.,
- **Përmbajtjen:** bota si bashkësi globale, sfidat e ndërvarësisë globale etj,
- **Temat:** strehimi, komunikimi etj,

2. Si mund të ndihmojë lënda e gjeografisë në trajtimin e çështjeve të lëndës së qytetarisë:

- Ndhmon nxënësit të kuptojnë më mirë ndikimin e veprimtarisë ekonomike tek njerëzit dhe te bashkësia ku jetojnë;
- Nxjerr në pah marrëdhëniet ndërmjet zhvillimeve vendore, kombëtare dhe globale;
- Nxjerr në pah mundësinë e qytetarëve për të ndikuar në jetën e bashkësisë dhe më gjerë;
- Shqyrton në gjerësi dhe në thellësi çështje të zhvillimit të qendrueshëm;
- Nxit respektin për njerëz dhe kultura të tjera si dhe për mjedisin.

3. Në ç' mënyrë lënda e qytetarisë ndihmon në zhvillimin e lëndës së gjeografisë? Qytetaria:

- Zbulon lidhjet e çështjeve me të cilat merret lënda e gjeografisë me jetën e përditshme të nxënësve dhe rrit interesin e tyre për to.
- Ndhmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e lëndës së gjeografisë.
- Nxit të kuptuarit e çështjeve që lidhen me zhvillimin, për shembull, tregtinë e ndershme.
- Nxit nxënësit të marrin pjesë në zhvillimin e projekteve të ndryshme në bashkësinë ku jetojnë, për shembull, për çështje mjedisore.

## **2.5. Kompetencat e lëndës dhe tematikat e saj**

Procesi i të nxënimit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi”, në të gjitha shkallët, ka në fokus kryesisht zhvillimin e kompetencës shoqërore dhe qytetare, si një ndër kompetencat kyçe si dhe, në sasinë dhe cilësinë e mundshme, të kompetencave të tjera.

Kjo kompetencë përbëhet nga kompetencat personale, ndërpersonale dhe ndërkulturore që përfshijnë dhe lidhen me të gjitha qëndrimet që përgatitin individët për të marrë pjesë në mënyrë të efektshme dhe konstruktive në jetën dhe punën shoqërore dhe, në mënyrë të veçantë, në shoqëritë gjithnjë e më të larmishme, për të zgjidhur konfliktet atje, atëherë dhe kur kjo është e nevojshme.

Kompetenca shoqërore dhe qytetare i përgatit individët për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore, ekonomike, politike etj. dhe për t’iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

Nxënësi njih dhe pranon rëndësinë që ka zhvillimi i kompetencave të qytetarisë për përgatitjen për të marrë pjesë plotësisht në jetën qytetare, duke u bazuar në njohuritë për konceptet dhe strukturat shoqërore dhe politike dhe për t’iu përkushtuar pjesëmarrjes aktive e demokratike.

Nxënësi argumenton rëndësinë që ka kompetenca shoqërore dhe qytetare për të motivuar pjesëmarrjen e efektshme me të tjerët në jetën publike dhe për t’u solidarizuar në zgjidhjen e problemeve që lidhen me komunitetin lokal dhe më gjerë.

Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare zhvillohet duke bazuar në njohuritë për ligjësitë dhe konceptet themelore të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë, të qytetarisë dhe të të drejtave të njeriut,.

Nxënësi argumenton që kompetenca shoqërore dhe qytetare bazohet në njohuritë historike për ngjarjet dhe prirjet themelore të zhvillimit të historisë së njerëzimit dhe asaj kombëtare, në njohuritë për ligjësitë dhe ngjarjet bashkëkohore dhe në prirjet për të ardhmen.

Nxënësi përdor konceptin e kohës dhe të hapësirës në të gjitha gjykimet dhe vendimmarrjet e tij në fushën e historisë, shoqërisë, filozofisë etj.

Nxënësi zhvillon këndvështrimin e tij hapësinor për botën, kupton vendndodhjen e njerëzve, të rajoneve, të vendeve si dhe të burimeve dhe shpjegon arsyen e kësaj vendndodhjeje.

Nxënësi eksploron konceptet themelore gjeografike dhe marrëdhëniet ndërmjet qenieve njerëzore me mjedisin.

Nxënësi pranon rëndësinë që ka kompetenca kompetenca shoqërore dhe qytetare për reflektimin kritik e krijues dhe për pjesëmarrjen konstruktive në veprimtaritë e komunitetit ose të fqinjësisë si dhe në proceset e vendimmarrjes, veçanërisht përmes votimit, në nivel vendor, kombëtar dhe Evropian.

Nxënësi kupton mënyrën si individët mund të sigurojnë shëndetin e tyre më të mirë mendor, intelektual e fizik, në shërbim të vetes, të familjes dhe të mjedisit të tyre shoqëror. Ata njohin lidhjen e mënyrës së shëndetshme të jetesës me zhvillimin e tyre tërësor dhe veprojnë për të realizuar atë.

Nxënësi njihet konceptet themelore që lidhen me individët, grupet etj. me barazinë dhe mosdiskriminimin gjinor, me shoqërinë dhe kulturën. Ai kupton dhe merr vendime mbi bazën e të kuptuarit të dimensioneve shumëkulturore, ekonomike, ligjore, politike e shoqërore të shoqërisë Evropiane si dhe të ndërveprimit të identitetit kulturor kombëtar me atë Evropian e më gjerë.

Nxënësi komunikon në mënyrë konstruktive në mjedise të ndryshme dhe shfaq aftësinë për tolerancë, për të shprehur dhe kuptuar këndvështrimet e ndryshme, për të negociuar, për të krijuar besim dhe për të kuptuar ndjenjat dhe qëndrimet e të tjerë.

Nxënësi është i vetëdijshëm që kompetenca bazohet në ndjenjën e integritetit, të bashkëpunimit, të pohimit të vetvetes pa përjashtuar tjetrin. Ai pranon se individët duhet të interesohen për zhvillimet ekonomike, politike, shoqërore, në nivel kombëtar dhe global dhe për komunikimin ndërkulturor.

Ata vlerësojnë diversitetin, respektojnë të tjerët dhe përgatiten për të kapërcyer paragjykimet dhe për të arritur kompromise.

Nxënësit zhvillojnë vetëdijen për qëllimet, vlerat dhe lëvizjet politike në nivel kombëtar dhe Evropian si dhe vetëdijen për diversitetin dhe identitet kulturor në Evropë.

Tematikat mbi të cilat është organizuar përmbajtja e programit kanë të bëjnë me njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat, nëpërmjet të cilave, do të realizohen këto kompetenca. Shkathtësitë dhe qëndrimet, ashtu sikurse njohuritë, janë objekt i të nxënësve të rregullt dhe progresiv. Shkathtësitë dhe aftësitë u lejojnë nxënësve, që nën udhëheqjen e mësuesit apo në mënyrë të pavarur, të ndërtojnë, përvetësojnë, mobilizojnë njohuritë dhe të reflektojnë mbi to. Këto tematika janë

- Individët, grupet, shoqëria
- Kultura
- Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

- Pushteti, autoriteti, qeverisja

## 2.6. Koha mësimore për tematikë për secilën klasë

Programi i lëndës së qytetarisë (Njohuri për shoqërinë klasa K-2) zhvillohet në 35 orë mësimore në vit. Programi specifikon orët e sugjeruara për secilën tematikë, për secilën klasë. Orët e sugjeruara përfshijnë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo projektet, vëzhgimet në natyrë, testimet e ndryshme. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetore të lëndës, kurse janë të lirë të ndryshojnë me 10% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara për secilën tematikë.

### 3. Tabela. Orët përkatëse mësimore të tematikave për klasën përgatitore

Tematika Shkalla	Individët, grupet, shoqëria	Kultura	Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia	Ndërvarësia midis njerëzve, vendeve, rajoneve dhe mjediseve	Pushteti, autoriteti, qeverisja	Proceset shoqërore	Prodhimi, konsumi, shpërndarja	Totali i orëve
<b>Shkalla 1</b>								
Klasa përgatitore	20	10	10	5	10	5	10	<b>70</b>
Klasa e parë	20				8		7	<b>35</b>
Klasa e dytë	20				8		7	<b>35</b>
<b>Shkalla 3</b>								
Klasa e gjashtë	13	13					9	<b>35</b>

### 3. REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E PARË

Në programin e qytetarisë për të gjitha shkallët janë paraqitur rezultatet e të nxënit sipas tematikave të kurrikulës bërthamë. Rezultatet e të nxënit shprehen në terma njohurish, aftësish dhe qëndrimesh. Tematikat dhe renditja e tyre nuk nënkuptojnë që përmbajtja vjetore, përgjatë vitit shkollor, duhet të zhvillohet e ndarë në këtë renditje. Kombinimi dhe ndarja e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve në situata të nxëni, kapituj ose grupe temash e njësi mësimore, si dhe renditja e tyre është e drejtë e përdoruesve të programit (më kryesorët janë autorët e teksteve dhe mësuesit). Sasia e orëve mësimore për secilën tematikë është relativisht rekomanduese.

Në shkallën e parë (klasa K-2) programi i qytetarisë zhvillohet në emrin “**Njohuri për shoqërinë**”

#### **Klasa përgatitore**

##### **Tematika 1: Individët, grupet, shoqëria**

##### **Përshkrimi i tematikës:**

Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkejetesën paqësore në shoqëri.

##### **Rezultatet e të nxënit**



Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- I konceptit për veten</li> <li>- I konceptit për familjen</li> <li>- I konceptit për komunitetin</li> <li>- I konceptit për klasën dhe shkollën</li> <li>- I konceptit e të drejtave të fëmijës</li> <li>- I konceptit për shoqërinë dhe miqësinë</li> <li>- Për bashkëveprimin me të tjerët</li> <li>- Për marrëdhëniet brenda grupit</li> <li>- Për të drejtat e fëmijëve</li> </ul> <p><b>Konceptet kryesore:</b> <i>Unë, ti, familja, klasa, lagjja, nevoja, dëshira, dallimi, e përbashkëtat, unë dhe tjetri, përgjegjësi, respekt, nevoja të përbashkëta, dëshira të përbashkëta, punë e përbashkët, punë shtëpie, punë klase, punë në komunitet, respekt,</i></p>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Flet dhe përshkruan veten.</li> <li>• Tregon për gjërat që i pëlqejnë.</li> <li>• Tregon ngjarje personale, familjare dhe shoqërore.</li> <li>• Tregon 2-3 tipare që e dallojnë nga të tjerët.</li> <li>• Dallon rolet e veçanta që individët kanë në familje, klasë, grup, lagje etj.</li> <li>• Përdor të drejtat që ia lejon ligji.</li> <li>• Shpreh nevojat dhe dëshirat e tij.</li> <li>• Dallon lidhjet që ai ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- njerëzit e familjes,</li> <li>- shokët (në shkollë e jashtë saj),</li> <li>- mësuesen,</li> <li>- sendet me të cilat ka lidhje në jetën e përditshme,</li> <li>- mjedisin etj.</li> </ul> </li> <li>• Dallon nevojën që ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon.</li> <li>• Dallon atë çfarë mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon.</li> <li>• Shpreh përgjegjësinë e tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.</li> </ul>	<p>Fëmija</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimet, ndjenjat, dëshirat e tij.</li> <li>• Beson te vetja dhe tek të tjerët.</li> <li>• Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.</li> <li>• Respekton vetveten.</li> <li>• Tregon interes për nevojat e të tjerëve.</li> <li>• Ndan gjërat me shokët e klasës.</li> <li>• Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.</li> <li>• Bashkëvepron me të tjerët me bindjen se kjo është e nevojshme.</li> <li>• Tregon gadishmëri për të ndihmuar shokët, të moshuarit etj.</li> </ul>

**Tematika 2: Kultura****Përshkrimi i tematikës:**

Nxënësit kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë ku jetojnë, si dhe jetën dhe shoqëritë e të tjerëve dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre, në emër të respektimit të diversitetit kulturor dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.

**Rezultatet e të nxënit**

Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- jetën në komunitet</li> <li>- ngjashmëritë dhe ndryshimet me të tjerët</li> <li>- sjelljen qytetare</li> <li>- etikën si e mirë e përbashkët</li> <li>- fqinjësinë e mirë</li> <li>- simbolet kombëtare</li> <li>- gjuhën, zakonet dhe traditat</li> <li>- gatimet dhe ceremonitë tradicionale/festive</li> <li>- ditët dhe datat e shënuara</li> <li>- përkatësia dhe respekti për veten</li> <li>- vlerat njerëzore</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon ngjashmëritë me të tjerët brenda grupit shoqëror në të cilin bën pjesë (familje, klasë, komunitet).</li> <li>• Dallon ndryshimet më të dukshme kulturore brenda grupit shoqëror në të cilin bën pjesë (familje, klasë, komunitet).</li> <li>• Shpreh mendime pozitive për veten dhe për shokët e "ndryshëm".</li> <li>• Sillet në mënyrë qytetare.</li> <li>• Përdor fjalët magjike.</li> <li>• Shpreh krenari për identitetin kombëtar.</li> <li>• Vlerëson tipare të veçanta që shfaqin bashkëmoshatarët.</li> <li>• Kërkon zbatimin e të drejtave që i takojnë.</li> </ul>	<p>Fëmija</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kupton se pavarësisht ndryshimeve, të gjithë janë të barabartë.</li> <li>• Vlerëson sjelljet qytetare në interes të së mirës së përbashkët.</li> <li>• Merr pjesë me dëshirë në ceremoni festive.</li> <li>• Shfaq respekt për veten dhe për të tjerët.</li> <li>• Gëzohet kur merr pjesë në festa, ditë e data të shënuara.</li> </ul>

**Tematika 3: Kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia****Përshkrimi i tematikës:**

Duke studiuar të kaluarën dhe trashëgiminë e saj, nxënësit kuptojnë konceptet kyçe historike si; kronologjia, ndryshimi dhe

vazhdimësia, lidhjet shkak- pasojë, shumëllojshmëria kulturore etnike dhe fetare, rëndësia dhe perspektiva, fillimisht nëpërmjet njohjes dhe kuptimit të historisë personale dhe familjare, historisë së shkollës, historisë së zonës, rajonit për t'u zgjeruar më pas në njohjen dhe kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore. Kuptimi i kronologjisë aftëson nxënësit të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Nxënësit kuptojnë rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve, shoqërisë dhe mjedisit, duke njohur disa nga ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur, duke filluar nga elementët e jetës së përditshme e deri në ndryshimet shoqërore, ekonomike, kulturore, që kanë formësuar botën.

### Rezultatet e të nxënit

Njohuritë	Shkathhtësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rritjen dhe ndryshimet që ndodhin gjatë saj</li> <li>- Përkatësinë gjininë</li> <li>- Brezat në familje</li> <li>- Historikun e shkollës</li> <li>- Ndryshimet në veshje, shije, ushqime, lodra etj., që ndodhin me rritjen e njeriut</li> <li>- Ndryshimi i vendbanimit</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dallon ndryshimet që i kanë ndodhur gjatë rritjes.</li> <li>• Rendit ngjarjes sipas kohës kur kanë ndodhur.</li> <li>• Flet për momente të veçanta të jetuara në familje, kopsht, shkollë.</li> <li>• Lidh kohën me elemente, objekte, shenja apo gjëra të veçanta.</li> <li>• Ilustron me shembuj, vizatime, foto, regjistrime filmike, ngjarje të ndodhura në kohë të ndryshme.</li> <li>• Rendit pjesëtarët e familjes sipas moshës.</li> <li>• Bën dallime ndërmjet mjediseve ku i është dashur të jetojë, mësojë, luajë</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh ndjenja dhe emocione pozitive për të kaluarë e vet.</li> <li>• Shpreh pëlqim ose mospëlqim sipas situatës apo kontekstit në/ për të cilin ndodhet/ flitet.</li> <li>• Mban qëndrimin e duhur në situata të vështira.</li> <li>• Vlerëson përparimin e teknologjisë, shkencës, të shoqërisë duke u nisur nga jeta e përditshme.</li> <li>• Justifikon veprime/ gabime që ka bërë kur ka qenë më i vogël.</li> </ul>

#### Tematika 4: Njerëz, vende dhe mjedise

##### Përshkrimi i tematikës:

Duke studiuar të kaluarën dhe trashëgiminë e saj, nxënësit kuptojnë konceptet kyçe historike si; kronologjia, ndryshimi dhe vazhdimësia, lidhjet shkak- pasojë, shumëllojshmëria kulturore etnike dhe fetare, rëndësia dhe perspektiva, fillimisht nëpërmjet

njohjes dhe kuptimit të historisë personale dhe familjare, historisë së shkollës, historisë së zonës, rajonit për t'u zgjeruar më pas në njohjen dhe kuptimin e historisë së vendit dhe atë të qytetërimeve botërore. Kuptimi i kronologjisë aftëson nxënësit të kuptojnë vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe marrëdhënien shkak-pasojë. Nxënësit kuptojnë rolin e kohës në ndryshueshmërinë e njerëzve, shoqërisë dhe mjedisit, duke njohur disa nga ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur, duke filluar nga elementët e jetës së përditshme e deri në ndryshimet shoqërore, ekonomike, kulturore, që kanë formësuar botën.

<b>Rezultatet e të nxënit</b>		
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë dhe aftësitë</b>	<b>Qëndrimet dhe vlerat</b>
<p>Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërvarësinë në shoqëri</li> <li>- Ndërvarësinë me mjedisin</li> <li>- Përgjegjësinë për mjedisin dhe shoqërinë</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndjen rëndësinë e marrëdhënieve me të tjerët.</li> <li>• Tregon kujdes për mjedisin ku jeton.</li> <li>• Dallon detyrat si pjesëtar komuniteti.</li> <li>• Dënon rastet dhe sjelljet e gabuara në shoqëri dhe në mjedis.</li> <li>• Përkrah disa nga cilësitë që duhet të ketë shoku të cilat ushqejnë miqësinë dhe marrëdhëniet pozitive.</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shpreh mendimin personal.</li> <li>• Gjen shkakun dhe pasojën në një situatë të dhënë.</li> <li>• Mban përgjegjësi për veprimet që kryen.</li> </ul>

### **Tematika 5: Pushteti, autoriteti, qeverisja**

#### **Përshkrimi i tematikës:**

Përmes kësaj tematike, nxënësit fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit, dhe ndërgjegjësohen që ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive, janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

<b>Rezultatet e të nxënit</b>		
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë dhe aftësitë</b>	<b>Qëndrimet dhe vlerat</b>
Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe	Fëmija:	Fëmija:

<p>kuptimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të drejtat e fëmijëve</li> <li>- Rregullat në shtëpi, shkollë, rrugë, lojë</li> <li>- Detyrat dhe përgjegjësitë</li> <li>- Menaxhimi i konflikteve dhe zgjidhja e tyre paqësore</li> <li>- Roli i individit në familje, shkollë e shoqëri</li> <li>- Punët në familje.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rendit disa rregulla të lojës që ai zbaton ne mjedisin ku jeton, luan, mëson.</li> <li>• Merr pjesë në hartimin e rregullave në shkollë.</li> <li>• Zbaton rregullat e ecjes në rrugë.</li> <li>• Zbaton rregullat që lidhen me sigurinë në shtëpi, shkollë, rrugë dhe këndin e lojërave.</li> <li>• Parandalon sjellje, veprime agresive.</li> <li>• Pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar.</li> <li>• Vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme.</li> <li>• Veçon shokët që zbatojnë dhe nuk zbatojnë rregullat e klasës.</li> <li>• Zbaton shprehitë kryesore të nevojshme për përdorimin e rrugës edhe në rastet kur është i shoqëruar nga një i rritur ose nga një fëmijë më i madh.</li> <li>• Tregon domethënien e disa prej tabelave kryesore sinjalistike që vendosen në rrugë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjen mënyrën e duhur për të zgjidhur një situatë konfliktuale.</li> <li>• Tregohet i gatshëm për të zbatuar rregullat e vendosura.</li> <li>• Ndien përgjegjësi në hartimin e rregullores së klasës.</li> <li>• Dënon rastet e shkeljes së rregullave dhe personat përgjegjeës.</li> </ul>
--	--	---

## **Tematika 6: Proceset shoqërore**

### **Përshkrimi i tematikës:**

Proceset shoqërore përfshijnë zhvillimet dhe ndryshimet që ndodhin në jetën shoqërore, në mjedisin ku jeton, në nivel vendor, rajonal dhe global. Këto procese ndodhin në të gjitha fushat e jetës dhe të veprimtarisë shoqërore (fusha ekonomike, politike, shoqërore, ligjore, kulturore etj.) dhe në korrelacion me njëra-tjetrën, ndikojnë jetën tonë dhe të shoqërisë. Njohja e këtyre proceseve, e ligjshmërisë dhe e lidhjeve shkak-pasojë është domosdoshmëri për vendimmarrjet tona dhe për shkallën tonë të lirisë në këtë proces vendimmarrje.

Vetëm në këtë bazë, pjesëmarrja qytetare do të jetë e përgjegjshme, e vetëdijshme, aktive dhe e orientuar nga e ardhmja dhe zhvillimi i qëndrueshëm.

### Rezultatet e të nxënit

Njohuritë	Shkathtësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngjarje të caktuara shoqërore, kulturore dhe historike</li> <li>- Ndryshimet që ka pësuar komuniteti ku jeton</li> <li>- Lidhja e figurave të shquara me një atribut të caktuar në kohë të caktuar</li> <li>- Muzeumet historike dhe etnografike</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan si jetojnë dhe si punojnë njerëzit në komunitet.</li> <li>•</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Merr pjesë aktive në ngjarje të rëndësishme për bashkëmoshatarët e tyre.</li> <li>• Vlerëson figurat e shquara historike.</li> </ul>

### Tematika 7: Prodhimi, konsumi, shpërndarja

#### Përshkrimi i tematikës:

Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe reagimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.

### Rezultatet e të nxënit

Njohuritë	Shkathtësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Fëmijës i mundësohet njohja, diskutimi dhe kuptimi për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëshirat dhe nevojat</li> <li>- Zgjedhja e duhur</li> <li>- Profesionet e prindërve</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bën dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave.</li> <li>• Flet për rëndësinë që kanë për të ushqimi,</li> </ul>	<p>Fëmija:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Respekton profesionet dhe shërbimet e ndryshme që kryhen në</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ardhurat në familje</li> <li>- Paraja, kursimi, përdorimi</li> <li>- Arka e kursimit</li> <li>- Dhuratat për ditëlindjen</li> <li>- Shërbimet që ofron komuniteti</li> </ul>	<p>veshja, banesa, familja, lojërat, dashuria dhe respekti, librat, siguria etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përshkruan punët që bëjnë njerëzit e familjes për të siguruar paratë.</li> <li>• Tregon se si familjet i përdorin paratë për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre.</li> <li>• Dallon disa nga shërbimet për të cilat njerëzit kanë nevojë në lagjen ku banojnë.</li> <li>• Dallon disa nga institucionet që mund të ofrojnë shërbime për komunitetin ku jeton (për shembull, tregon se çfarë shërbime mund ofrojnë ambulanca, policia, zjarrfikësja etj.).</li> <li>• Tregon se çfarë mund dhe duhet të bëjnë fëmijët dhe banorët e tjerë të komunitetit për të rritur cilësinë e shërbimeve dhe të përfitimit prej tyre.</li> </ul>	<p>shoqëri.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shfaq respektin për njerëzit që punojnë.</li> <li>• Vlerëson përpjekjet që bëjnë prindërit për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e fëmijëve.</li> <li>• Justifikon me raste konkrete pse nevojat e familjes janë mbi dëshirat personale të fëmijëve.</li> <li>• Pranon rëndësinë e pjesëmarrjes së tij në komunitet.</li> </ul>
--	--	--

## Klasa parë

<p><b>Tematika 1: Individët, grupet, shoqëria</b>  <b>Përshkrimi i tematikës:</b></p>
<p>Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkejetesën paqësore në shoqëri.</p>
<p><b>Rezultatet e të nxënësve</b></p>
<p><b>Unë dhe të tjerët</b>  <b>10 orë</b></p>

Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Nxënësi njeh vetveten, tiparet, dëshirat, nevojat etj.</p> <p>Nxënësi njeh çfarë e dallon dhe e bën të veçantë në raport me të tjerët dhe ato që ai i ka të përbashkëta me ta: (nevoja, dëshira, ëndrra, tipare të jashtme, prejardhje etj.)</p> <p>Nxënësi njihet/zbulon vetë etj, me tiparet që janë thelbësore nga ato që nuk janë të tilla në dallimet dhe të përbashkëtat që ka me të tjerët dhe i jepet mundësia të kuptojë arsyet e ndryshimeve dhe ngjashmërive.</p> <p>Nxënësit i mundësohet të njohja dhe kuptimi i lidhjeve që ekzistojnë ndërmjet tij dhe të tjerëve dhe i nevojës që ai ka për të tjerët. Ai fillon të mësojë për rëndësinë e ndihmës së ndërsjellë për të plotësuar nevojat e përbashkëta.</p> <p>Nxënësit i jepet mundësia të kuptojë rëndësinë e disa detyrimeve që secili duhet të ketë ndaj grupit ku bën pjesë</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shpreh tiparet e tij kryesore që e dallojnë atë nga të tjerët;</li> <li>• dallon tiparet e njerëzve që përbëjnë botën në të cilën ai jeton;</li> <li>• vendos veten në një mjedis të caktuar (familje, klasë, lagje etj.) dhe e sheh veten si pjesë e tij;</li> <li>• shpreh nevojat dhe dëshirat e tij;</li> <li>• dallon nevojat dhe dëshirat e të tjerëve, të përbashkëtat dhe ato që ndryshojnë</li> <li>• jep një shpjegim për këto ndryshime, për ndryshimet dhe të përbashkëtat që janë ndërmjet tij dhe të tjerëve etj</li> <li>• dallon lidhjet që ai ka me mjedisin që e rrethon dhe me njerëzit që e përbëjnë atë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- njerëzit e familjes,</li> <li>- shokët (në shkollë e jashtë saj),</li> <li>- mësuesit,</li> <li>- sendet me të cilat ka lidhje në jetën e përditshme,</li> <li>- mjedisi etj.</li> </ul> </li> <li>• dallon dhe të vlerëson nevojën që ai ka për njerëzit dhe mjedisin që e rrethon;</li> <li>• dallon dhe të vlerëson atë çfarë ai mund t'u japë të tjerëve dhe mjedisit që e rrethon;</li> <li>• vlerëson mendimet dhe qëndrimet e veta dhe të të tjerëve;</li> <li>• shpreh përgjegjësinë e tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit etj.</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Tregon interes për nevojat e të tjerëve</li> <li>- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij.</li> <li>- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup.</li> <li>• respekton vetveten dhe të shpreh me besim qëndrimin e tij</li> </ul>



	<p><b>Konceptet kryesore:</b> <i>Unë, ti, familja, klasa, lagja, nevoja, dëshira, dallimi, e përbashkëtat, unë dhe tjetri, përgjegjësi, respekt, e drejtë, e gabuar, nevoja të përbashkëta, dëshira të përbashkëta, përgjegjësi e përbashkët</i></p>	
<p><b>Të bashkëveprojmë</b> <b>10 orë</b></p>		
<p>Nxënësi njihet me rolet e ndryshme që ekzistojnë në nivele të ndryshme të veprimtarisë njerëzore (në familje, grup, klasë etj.).</p> <p>Nxënësit i jepet mundësia të eksplorojnë rolin e tij dhe të shokëve të tij në grup, klasa, familje etj. dhe të flasë për rëndësinë që ka përbushja e këtyre roleve nga secili.</p> <p>Nxënësi njihet me disa prej veprimtarive njerëzore në fusha të ndryshme në të cilat bashkëveprimi është i domosdoshëm.</p> <p>Nxënësi zbulon rëndësinë e bashkëveprimit në kryerjen e të gjitha roleve në shoqëri dhe flet për rëndësinë e saj.</p> <p>Nxënësit i jepet mundësia të dëshmojnë të kuptuarit e bashkëveprimit në veprimtari të thjeshta në shkollë e komunitet.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon rolet e veçanta që çdo individ ka në shoqëri (në familje, klasë, grup, lagje etj.);</li> <li>• vlerëson rolin e tij dhe të tjerëve në familje, klasë, grup, lagje etj.;</li> <li>• bashkëvepron me të tjerët në familje, klasë, grup, lagje etj., për të zgjidhur probleme të ndryshme;</li> <li>• pranon që ka njerëz që kanë vështirësi për të kuptuar dhe për të bërë gjëra të ndryshme dhe të tregojë gatishmërinë për t'i ndihmuar ata etj.;</li> <li>• flet për rëndësinë e punës së përbashkët për plotësimin e nevojave dhe të dëshirave të individëve dhe të grupeve ku ata bëjnë pjesë</li> </ul> <p><b>Konceptet kryesore:</b> <i>rol shoqëror, punë e përbashkët, punë shtëpie, punë klase, punë në komunitet, respekt, vështirësi etj.</i></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale.</li> <li>• Respekton idetë dhe përvojat e të tjerëve.</li> <li>• Beson te vetja dhe tek të tjerët</li> <li>• Bashkëvepron me të tjerët me bindjen se kjo është e nevojshme.</li> </ul>
<p><b>Tematika 2: Pushteti, autoriteti, qeverisja</b></p>		

Përmes kësaj tematike, nxënësit fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit, dhe ndërgjegjësohen që ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive, janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.

**Rezultatet e të nxënit**  
**Rregullat**  
**4 orë**

Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Nxënësi njihet me rregullat që shoqëria ka vendosur për të kryer punët dhe detyrat e tjera me karakter shoqëror.</p> <p>Nxënësit i krijohet mundësia të marrë pjesë në vendosjen e rregullave të thjeshta:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• për organizimin e një loje ku marrin pjesë nxënësit;</li> <li>• për organizimin e një veprimtarie në klasë, në familje, në komunitet etj.</li> </ul> <p>Nxënësi vihet në situata mësimore që e ndihmojnë të kuptojë si shkelja e rregullave mund të dëmtojë atë dhe të tjerët.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon rregulla të caktuara në veprimtari të ndryshme që zhvillohen në familje, klasë, shkollë, lojë etj.;</li> <li>• pranon rëndësinë e vendosjes së rregullave në një veprimtari të caktuar;</li> <li>• vendos rregulla të thjeshta, në bashkëpunim me të tjerët, në veprimtaritë e tij të përditshme;</li> <li>• diskuton për rëndësinë e bashkëpunimit me të tjerët për të vendosur rregulla sa më të drejta për të gjithë etj.</li> </ul> <p>• <b>Konceptet kryesore:</b> <i>rregull, veprimtari shoqërore, bashkëpunim</i></p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• demonstroi gatishmërinë e tij për të ndjekur rregullat në veprimtaritë e përditshme në familje, grup, klasë, shkollë etj.;</li> </ul>

**Rregulla në shtëpi, shkollë, rrugë dhe në park**  
**4 orë**

Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Nxënësi njihet me disa nga rreziqet që janë të pranishme në shtëpi e shkollë.</p> <p>Nxënësi bëhet i vetëdijshëm se rregullat duhen</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• flet për rëndësinë e respektimit të rregullave të qarkullimit rrugor;</li> <li>• identifikon disa nga rregullat e</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• respekton rregullat në çdo fushë të veprimtarisë.</li> <li>• bashkëpunon me të tjerët</li> </ul>

<p>vendosur e zbatuar për të mos dëmtuar veten dhe të tjerët në shtëpi dhe shkollë.</p> <p>Nxënësi njihet me disa nga rreziqet që janë të pranishme në mjediset ku qarkullojnë njëkohësisht njerëz dhe mjete si biçikleta, motor, makina etj.</p> <p>Nxënësi njihet me disa nga rregullat e qarkullimit në mjedise publike (parqe, rrugë etj.) dhe përpiqet të përcaktojë disa sjellje e sigurta në rrugë.</p>	<p>sjelljes së tij në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- shtëpi,</li> <li>- rrugë,</li> <li>- park,</li> <li>- lagje.</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• liston sjelljet e duhura në situata të ndryshme jetësore në mjediset që ai frekuenton:</li> </ul> <p><b>Konceptet kryesore:</b> <i>Rrezik, rrymë elektrike, qarkullim, vija të bardha, kryqëzim, trotuar, polic trafiku, semafor etj.</i></p>	<p>për të vendosur rregulla të reja kur është e nevojshme.</p>
<p><b>Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi</b></p> <p>Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe reazimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b> <b>Familjet tona</b> <b>7 orë</b></p>		
<p><b>Njohuritë</b></p>	<p><b>Shkathësitë dhe aftësitë</b></p>	<p><b>Qëndrimet dhe vlerat</b></p>
<p>Nxënësi zbulon si njerëzit në një familje janë të ngjashëm dhe të ndryshëm, si ata punojnë së bashku për një jetë më të mirë</p> <p>Nxënësi bëhet i vetëdijshëm që të gjitha familjet, për të jetuar, duhet të kenë ushqim, veshje dhe shtëpi banimi.</p> <p>Ai fillon të kuptojë ndryshimin ndërmjet një nevojë dhe një dëshire.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon çfarë është familja</li> <li>• tregon si njerëzit jetojnë dhe punojnë së bashku në një familje.</li> <li>• shpjegon ndryshimet ndërmjet nevojave dhe dëshirave</li> <li>• dallon dhe përkufizon një profesion si një punë që duhet bërë .</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Respekton profesionet dhe shërbimet e ndryshme që kryhen në shoqëri</li> <li>• Respekton njerëzit e punës, pavarësisht nga lloji i punës që kryejnë.</li> </ul>

<p>Nxënësit mësojnë se si punët (profesionet) u sigurojnë anëtarëve të familjes plotësimin e nevojave dhe të dëshirave.</p> <p>Nxënësit skicojnë anëtarët e familjes duke bërë punë të ndryshme.</p> <p>Nxënësit zbulojnë në një hartë, vendet ku anëtarët e familjes së tyre shkojnë për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre.</p> <p>Nxënësit mësojnë për rëndësinë që ka puna për të paguar për nevojat dhe dëshirat tona</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon profesione të ndryshme</li> <li>• përcakton një simbol për një punë dhe shërbim të caktuar.</li> <li>• vendos në hartë simbole të ndryshme për punë dhe shërbime.</li> <li>• tregon se si anëtarët e familjes janë të varur nga puna që bëjnë për të siguruar nevojat dhe dëshirat</li> <li>• përshkruan punët që njerëzit bëjnë për të siguruar paratë.</li> <li>• tregon se si familjet i përdorin paratë për të plotësuar nevojat dhe dëshirat e tyre.</li> </ul>	
--	--	--

## Klasa e dytë

<b>Tematika 1: Individët, grupet, shoqëria</b> Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkejetesën paqësore në shoqëri.		
<b>Rezultatet e të nxënit</b> <b>Zhvillimi individual, nevojat, dëshirat, të drejtat</b> <b>12 orë</b>		
Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Nxënësi bëhet i vetëdijshëm për nevojat dhe dëshirat e tij dhe të të tjerëve (anëtarëve të familjes, shokëve të klasës etj.)</p> <p>Nxënësi bëhet i vetëdijshëm për dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave.</p> <p>Nxënësi mëson për rëndësinë parësore të nevojave në raport me dëshirat.</p> <p>Ati i krijohen situata që e ndihmojnë të kuptojë se nevojat themelore të njeriut janë në bazë të të drejtave të tij dhe të shokëve të tij.</p> <p>Ai mëson disa nga të drejtat kryesore dhe merr pjesë vetë në hartimin e një liste të drejtash për fëmijët.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• radhit disa nga tiparet që e karakterizojnë atë si njeri;</li> <li>• tregon ku dallon dhe çfarë ka të ngjashme me shokët e klasës, me anëtarët e familjes (gjyshërit, prindërit, vëllezërit, motrat etj.);</li> <li>• përmend dhe të flet për disa nga nevojat dhe dëshirat bazë të tij dhe të shokëve duke bërë dhe dallimin ndërmjet tyre:             <ul style="list-style-type: none"> <li>- nevojat dhe dëshirat vetjake</li> <li>- nevojat e familjes</li> <li>- nevojat dhe dëshirat e shokëve etj.;</li> </ul> </li> <li>• flet për vlerat dhe rëndësinë që kanë për të ushqimi, veshja, banesa, familja, lojërat, dashuria dhe respekti, librat, mbrojtja nga rreziqet etj.;</li> <li>• argumenton pse plotësimi i nevojave, si:</li> </ul>	<p>Nxënësi respekton nevojat dhe dëshirat e të tjerëve.</p>

	<p>ushqimi, veshja, banesa, lojërat, mësimi etj., përbën një të drejtë që i takon si atij, edhe të tjerëve;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• zbulon të drejtat që lidhen me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- familjen</li> <li>- punën</li> <li>- banesën</li> <li>- ushqimin</li> <li>- mirësjelljen etj.;</li> </ul> </li> <li>• flet për rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe të tjerët; <ul style="list-style-type: none"> <li>- e drejta për t'u ushqyer.</li> <li>- e drejta për të luajtur etj.</li> </ul> </li> </ul>	
<b>Rezultatet e të nxënit</b> <b>Përgjegjësia ndaj vetes, të tjerëve, komunitetit</b> <b>8 orë</b>		
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathtësitë dhe aftësitë</b>	<b>Qëndrimet dhe vlerat</b>
<p>Nxënësit i mundësohet të kuptuarit e thjeshtë të faktit që realizimi i nevojave dhe i të drejtave të tij bëhet i mundur vetëm nëse të gjithë anëtarët e grupit dhe të komunitetit ku ai bën pjesë bëhen të përgjegjshëm për fatin e këtij komuniteti.</p> <p>Atij i mundësohet njohja me raste të shkeljes ose të mosrespektimit të të drejtave të tij nga të tjerët si dhe të identifikimit të sjelljeve vetjake që kanë qenë shkelje të të drejtave të shokëve ose të shoqeve.</p> <p>Vetëm nëse respektohen të drejtat e tjetrit, krijohet mundësia të respektohen të drejtat vetjake.</p> <p>Të gjithë duhet të jemi të ndjeshëm ndaj</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon lidhjen ndërmjet sjelljeve vetjake dhe shkeljes së të drejtave të të tjerëve;</li> <li>• identifikon raste të shkeljes së këtyre të drejtave nga të tjerët dhe nga ai vetë në grup, në klasë etj.;</li> <li>• tregon me shembuj nga jeta e tij në grup, në klasë etj., se si indiferentizmi i tij ose i shokëve të tij ndaj fatit të të tjerëve ose ndaj shkeljeve të të drejtave të tyre ka sjellë si pasojë prishjen e grupit, të paqes, të harmonisë etj.</li> <li>• tregon raste kur shokët ose shoqet e tij janë treguar indiferentë ndaj shkeljes së të</li> </ul>	

<p>nevojave e interesave të tjerëve.</p> <p>Të gjithë duhet të jemi përgjegjës për të krijuar mundësinë për respektimin e të drejtave të të gjithëve</p> <p>Nxënësi vihet në kushte të tilla që e ndihmojnë të kuptojë konceptin e përgjegjësisë ndaj të tjerëve, duke filluar nga përgjegjësia ndaj shokëve e shoqeve të afërt, në familje, në klasë, në komunitet etj.</p> <p>Ai duhet të fillojë të pranojë se disa situata në këto mjedise varen prej tij: ai luan rol të rëndësishëm në grupin ku bën pjesë.</p> <p>Nxënësi njihet me konceptin e të mirës së përbashkët si kriter përzgjedhës i sjelljes së tij në grup dhe në komunitet, duke filluar në këtë mënyrë njohjen me konceptet e para etike.</p>	<p>drejtave të tij;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• reflekton dhe tregon raste të mungesës së përgjegjësisë së tij ndaj të drejtave, nevojave të të tjerëve.</li> <li>• tregon me shembuj se mund të luajë rol të rëndësishëm në ruajtjen e shoqërisë dhe miqësisë së mirë në grup dhe në klasë;</li> <li>• dallon aspekte të të mirës së përbashkët për grupin dhe klasën ku bën pjesë;</li> <li>• vlerëson rëndësinë që ka respektimi i saj për ruajtjen e grupit dhe mbështetjen që anëtarët e tij duhet t'i japin njëri-tjetrit etj.</li> </ul>	
<p><b>Tematika 2: Pushteti, autoriteti, qeverisja</b></p> <p>Përmes kësaj tematike, nxënësit fitojnë dije dhe ndërtojnë njohuri për rregullat e jetës kolektive e kushtet demokratike për zbatimin e tyre, si dhe për mundësitë që ekzistojnë në një shoqëri demokratike në të gjitha nivelet e jetës politike. Ata ndërtojnë njohuri për institucionet publike demokratike dhe për rregullat e lirisë dhe të vepruarit, dhe ndërgjegjësohen që ndërtimi i institucioneve demokratike dhe gëzimi i këtyre lirive, janë përgjegjësi e të gjithë qytetarëve.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b> <b>Rregullat</b> <b>4 orë</b></p>		
<p><b>Njohuritë</b></p>	<p><b>Shkathhtësitë dhe aftësitë</b></p>	<p><b>Qëndrimet dhe vlerat</b></p>
<p>Nxënësi njihet me situata dhe veprimtari të ndryshme në familje, në mjedise publike, në lojë etj., në të cilat zbatohen dhe janë të domosdoshme për t'u zbatuar rregulla të</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• radhit disa nga rregullat në familje;</li> <li>• rendit disa rregulla të lojës që ai zbaton në mjedisin ku luan;</li> </ul>	<p>Shpreh qëndrimin e tij ndaj personave që nuk i zbatojnë rregullat në mjedise të ndryshme.</p>

<p>caktuara.</p> <p>Atij i krijohet mundësia të njihet me disa nga rregullat që lidhen me situata të caktuara dhe t'i dallojë ato kur këto situata përsëriten.</p> <p>Rregullat dhe pasojat e mungesës së tyre. Nxënësit i krijohet mundësia të propozojë disa rregulla për klasën dhe të tregojë arsyen pse i propozon ato. Nxënësi përgjithëson rolin që rregullat luajnë në përgjithësi.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• përmend disa nga rregullat që zbatohen ose nuk zbatohen në mjediset publike (në shkollë, qendër tregtare, park lodrash, kinema, bibliotekë, muze, ekspozitë);</li> <li>• propozon disa nga rregullat që duhet të përdoren në këto mjedise</li> <li>• propozon ndryshime që mund të , përmirësojnë rregullat e klasës;</li> <li>• shpjegon pse duhen rregullat e klasës.</li> <li>• veçon shokët që zbatojnë dhe nuk zbatojnë rregullat e klasës;</li> <li>• dallon problemet që lindin si rrjedhojë e mungesës së rregullave në mjediset publike.</li> </ul>	<p>Propozon rregulla</p>
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b> <b>Rruga</b> <b>4 orë</b></p>		
<p><b>Njohuritë</b></p>	<p><b>Shkathësitë dhe aftësitë</b></p>	<p><b>Qëndrimet dhe vlerat</b></p>
<p>Nxënësi njihet me rrugën e karakteristikat e saj, kthesat dhe përdorimet e tyre, rrugën e shtruar për këmbësorët etj.</p> <p>Ai njihet me disa nga shenjat e zakonshme që ai sheh ose ka parë dhe kuptimet e mesazhet e tyre.</p> <p>Nxënësi mëson tiparet e një mjedisi dhe situatë rrugore të sigurt, si dhe fjalorin përkatës për ta karakterizuar atë.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dallon rrugën, kthesat dhe përdorimet e tyre, të dallojë situatat kur mjetet mund të kalojnë rrugën e shtruar (për këmbësorët);</li> <li>• radhit disa nga shenjat e zakonshme që ai sheh ose ka parë dhe të tregojë nëse ato gjenden në rrugën e makinës ose të këmbësorit;</li> <li>• përdor fjalorin e duhur në një situatë rrugore të sigurt;</li> <li>• rendit tiparet e përbashkëta të disa mjeteve, për shembull, dritat, targën etj.,</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Respekton rregullat e sigurimit rrugor.</li> <li>• Dëgjon më të rriturit në rastet e kalimit të rrugës ose të mjediseve ku qarkullojnë mjete të ndryshme dhe kërkon ndihmën e tyre kur është e nevojshme.</li> </ul>



<p>Nxënësit i mundësohet njohja me tiparet e përbashkëta të disa mjeteve, për shembull, dritat, targa, përmasat e mjeteve të ndryshme.</p> <p>Ai mëson të njohë njerëzit që mund ta ndihmojnë të kalojë rrugën.</p> <p>Nxënësi familjarizohet me shprehite kryesore të nevojshme për përdorimin e rrugës kur është i shoqëruar nga një i rritur ose nga një fëmijë më i madh.</p> <p>Atij i krijohen situata në të cilat mëson për mjediset e sigurta të të lojës ose të qarkullimit dhe në të cilat atij i duhet të bëjë zgjedhjen e duhur në bazë të dijeve të mësuara për sigurinë në rrugë.</p>	<p>dhe të krahasojë masat e mjeteve të ndryshme;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përmend ata që mund ta ndihmojnë të kalojë rrugën dhe të përshkruajë rolet e tyre;</li> <li>• rendit shprehite kryesore të nevojshme për përdorimin e rrugës kur është i shoqëruar nga një i rritur ose nga një fëmijë më i madh;</li> <li>• dallon se disa nga mjediset e lojës janë më të sigurta se të tjerat;</li> <li>• dallon se njerëzit mund të bëjnë zgjedhje se cilën rrugë të zgjedhin kur ndërmarrin një udhëtim;</li> <li>• identifikon dhe të ushtron në praktikë, në situata të simuluar, sjellje të sigurta kur ecën me biçikletë.</li> </ul>	
<p><b>Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi</b></p> <p>Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe reazimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b></p>		
<p><b>Komuniteti ynë</b> <b>7 orë</b></p>		
<p><b>Njohuritë</b></p>	<p><b>Shkathtësitë dhe aftësitë</b></p>	<p><b>Qëndrimet dhe vlerat</b></p>
<p>Nxënësit studiojnë një poster të një komuniteti për të dalluar punët e ndryshme që kryhen në</p>	<p>Nxënësi:</p>	<p>Nxënësi:</p>

<p>të.</p> <p>Ata krijojnë një ide për mënyrën se si njerëzit jetojnë dhe punojnë në komunitet dhe bëhen të vetëdijshëm për nevojën e punës së përbashkët..</p> <p>Nxënësit, individualisht dhe në grup përdorin strategji të ndryshme për të simuluar prodhimin e një produkti.</p> <p>Nxënësit mësojnë për rolin ekonomik të qeverisë në një komunitet, duke dalluar shërbimet që qeveria siguron për qytetarët.</p> <p>Nxënësit tregojnë se qeveria duhet të mbledhë taksa për të paguar këto shërbime dhe shpjegojnë rëndësinë e taksave për vetë funksionimin e komunitetit.</p> <p>Nxënësit përcaktojnë variantin më të mirë të përdorimit të një dyqani të boshatisur.</p> <p>Procesi i vendimmarrjes hap pas hapi i ndihmon ata të kuptojnë se merren vendimet në grup.</p> <p>Nxënësit mësojnë për qarkullimin e parasë në ekonomi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>▪ dallon lloje të ndryshme punësh në komunitet</li> <li>▪ përshkruan si jetojnë dhe si punojnë njerëzit në një komunitet.</li> <li>▪ diskuton për mundësitë e ndryshme të punëve që ekzistojnë në një komunitet.</li> <li>▪ Përcakton një produkt.</li> <li>▪ Krahason metodën e prodhimit të një pjese të produktit me atë të montimit të të gjitha pjesëve</li> <li>▪ shpjegon që për prodhimin e produkteve të ndryshme përdoren metoda e strategji të ndryshme</li> <li>▪ dallon punët e ndryshme të qeverisjes në një komunitet</li> <li>▪ tregon pse taksat janë të nevojshme për komunitetin.</li> <li>▪ përkufizon zgjedhjen</li> <li>▪ përdor një model të marrjes së një vendimi</li> <li>▪ tregon nevojën e marrjes së vendimeve të menuara mirë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Respekton profesionet dhe shërbimet e ndryshme që kryhen në shoqëri</li> <li>• Respekton njerëzit e punës, pavarësisht nga lloji i punës që kryejnë.</li> </ul>
---	---	--

## REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS TEMATIKAVE PËR SHKALLËN E TRETË

### Klasa e gjashtë

Tematika: Individët, grupet, shoqëria		
<p>Nxënësit kuptojnë mënyrën si formohen, ruhen dhe ndryshojnë marrëdhëniet shoqërore. Ata dallojnë dhe shpjegojnë rolin dhe ndikimin e ndryshëm që kanë në shoqëri lloje dhe forma të caktura institucionesh sociale si: familja, shkolla, organizatat qytetare, arsimore, qeveritare dhe fetare dhe shqyrtojnë ndikimin e tyre në jetën e njerëzve. Ata studiojnë larminë e marrëdhënieve midis individëve dhe grupeve në shoqëri, eksplorojnë faktorët, që qëndrojnë në themel të tyre, mënyrën si funksionojnë dhe ndryshojnë. Nxënësit marrin vendime mbi bazën e njohurive të fituara në nivele të ndryshme shkollimi, për qëndrime e sjellje të ndryshme, që kanë lidhje me jetën dhe bashkëjetesën paqësore në shoqëri.</p>		
Rezultatet e të nxënit Komuniteti 13 orë		
Njohuritë	Shkathësitë dhe aftësitë	Qëndrimet dhe vlerat
<p>Nxënësi njihet me shërbimet që janë të domosdoshme për jetën normale të një komuniteti dhe me nevojat që ato plotësojnë në këtë komunitet.</p> <p>Nxënësi njihet me institucionet kryesore që janë përgjegjëse për shërbimet që kryhen në një komunitet.</p> <p>Ai mbledh opinione nga prindërit ose anëtarë të komunitetit në lidhje me shkallën në të cilën ata mendojnë se shërbimet në komunitet kryhen si duhet.</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>liston shërbimet që duhet të kryhen në një komunitet në interes të të gjithë anëtarëve të komunitetit dhe për krijimin dhe për ruajtjen e një komuniteti të shëndoshë;</li> <li>dallon përgjegjësinë e pushtetit vendor në kryerjen e shërbimeve në dobi të komunitetit si: shërbimet publike, rendi dhe qetësia publike, mirëmbajtja dhe mbrojtja e mjedisit etj.;</li> <li>identifikon raste kur pushteti vendor nuk i ka kryer si duhet detyrat e tij ndaj komunitetit;</li> <li>vjel opinionet e anëtarëve të komunitetit</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>merr pjesë në mënyrë vullnetare në veprimtaritë e klasës dhe të komunitetit, në emër të së mirës së përbashkët.</li> </ul>

<p>Ai ndërton edhe mendimin e tij në lidhje me shërbimet që kryhen ose duhet të kryhen në komunitetin në të cilin bën pjesë, duke filluar nga ato që ai vë re në komunitetin e vogël të shkallës, pallatit e më tej të lagjes.</p> <p>Nxënësit i jepet mundësia që të shqyrtojë rolin që anëtarët e një komuniteti mund të luajnë në ndihmë të institucioneve në kryerjen e shërbimeve komunitare.</p> <p>Ata eksplorojnë disa nga sjelljet e anëtarëve të komunitetit në të cilin jetojnë në shërbim të tij ose jo.</p> <p>Nxënësit shqyrtojnë shkallën e pjesëmarrjes së anëtarëve të komunitetit në zgjidhjen e problemeve të komunitetit dhe identifikojnë e analizojnë faktorët që ndikojnë në shkallën e pjesëmarrjes së qytetarëve në zgjidhjen e problemeve të komunitetit, veçanërisht në jetën në bashkëpronësi.</p>	<p>për cilësinë e kryerjes së shërbimeve në komunitet;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• diskuton për disa nga shërbimet komunitare që mund të realizohen më mirë në shërbim të komunitetit dhe sugjeron ide për përmirësimin e tyre;</li> <li>• përcakton shërbimet komunitare në të cilat roli i qytetarëve është shumë i rëndësishëm;</li> <li>• dallojnë përgjegjësitë e qytetarëve në shërbim të komunitetit, në varësi të llojit të shërbimit;</li> <li>• vlerësojnë shkallën në të cilët qytetarët në komunitetin e tyre luajnë rolin e tyre në shërbim të komunitetit;</li> <li>• analizojnë disa nga shkaqet e pjesëmarrjes së dobët të qytetarëve në komunitet;</li> <li>• vlerësojnë shkallën në të cilën ata ndihen përgjegjës për komunitetet në të cilat bëjnë pjesë (shkollë, pallat, lagje etj.);</li> <li>• shpjegojnë arsyet e pjesëmarrjes të tyre së ulët në shërbim të komunitetit etj.</li> <li>• diskuton për mundësitë e rritjes së përgjegjësisë dhe të pjesëmarrjes qytetare në shërbim të komunitetit.</li> </ul>	
<p><b>Tematika: Kultura</b></p> <p>Nxënësit kuptojnë si qeniet njerëzore krijojnë, mësojnë, ndajnë së bashku dhe përshtaten ndaj kulturës. Ata vlerësojnë rolin e kulturës në formimin e jetës dhe të shoqërisë, ku jetojnë, si dhe jetës dhe shoqërisë së të tjerëve dhe marrin vendime mbi bazën e njohurive për kulturën në faza të ndryshme të shkollimit të tyre në emër të respektimit të larmisë kulturore dhe të bashkëjetesës paqësore ndërmjet njerëzve dhe kulturave.</p>		

<b>Rezultatet e të nxënit</b> <b>Kultura</b> <b>13 orë</b>		
<b>Njohuritë</b>	<b>Shkathësitë dhe aftësitë</b>	<b>Qëndrimet dhe vlerat</b>
<p>Nxënësit i kërkohet të vëzhgojë, në klasë ose në komunitete të tjera, raste qëndrimesh të ndryshme për të njëjtën dukuri.</p> <p>Atij i mundësohet, me anë shembuj të ndryshëm, të kuptojë se një ndër arsytet përse njerëz të ndryshëm mbajnë qëndrime të ndryshme për të njëjtën dukuri është prejardhja e tyre e ndryshme kulturore ose nënkulturore.</p> <p>Nxënësit mësojnë disa nga elementët e kulturës si gjuha, muzika, veshjet e më tej vlerat, normat etj., të cilat i dallojnë grupet që i përkasin kulturave të ndryshme. Ata dallojnë ndryshimet që shokë të klasës shprehin si rrjedhojë e prejardhjes nga zona të ndryshme të vendit.</p> <p>Ata njihen me raste konfliktesh mes njerëzish, të cilat kanë pasur si shkak dallimet për arsye kulturore dhe disa nga pasojat e dëmshme që këto konflikte sjellin për individin, komunitetin, shoqërinë</p> <p>Ata ftohen të eksplorojnë, në komunitetin ku jetojnë, rastet e konflikteve ndërmjet shokëve e shoqeve për arsye të dallimeve që ekzistojnë ndërmjet tyre dhe sugjerojnë sjelljet pozitive</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>dallon faktin që individë të ndryshëm në grupin, në klasën ku bën pjesë kanë pikëpamje dhe përjetime të ndryshme për ngjarje, njerëz ose përvojat të ndryshme;</li> <li>lidh pikëpamjet e tiparet e ndryshme që janë karakteristikë e disa grupeve me përkatësinë e tyre kulturore;</li> <li>përshkruan se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat.</li> <li>tregon me shembuj ndikime të gjuhës, të letërsisë, të arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës.</li> <li>dallon dhe përshkruan shembuj të reagimit të ndryshëm të individëve ose grupeve të ndryshme ndaj dukurive të ndryshme etj., mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre.</li> <li>dallon raste konfliktesh që shkaktohen nga qëndrimet e ndryshme që njerëz nga kultura ose nënkultura të ndryshme mbajnë ndaj të njëjtës sjellje ose dukuri;</li> <li>shpjegon se njerëzit nga kultura të ndryshme, janë të ngjashëm në shumë aspekte të rëndësishme, si qenie njerëzore</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>pranon si plotësues të vetes individët e kulturave të ndryshme;</li> <li>pranon si të natyrshme faktin që njerëz nga kultura të ndryshme të kenë pikëpamje ose këndvështrime të ndryshme për çështje ose dukuri të caktuara të shoqërisë etj.</li> <li>respekton diversitetin në shoqëri etj.</li> </ul>

<p>për zgjidhjen dhe parandalimin e tyre.</p> <p>Ata ftohen në situata që kërkojnë zgjidhje konflikti dhe mësojnë procedurat e zgjidhjes paqësore të konfliktit.</p>	<p>që gëzojnë të njëjtat të drejta pavarësisht nga dallimet për arsye kulture, gjinie, race etj.</p>	
<p><b>Tematika: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi</b></p> <p>Përmes kësaj tematike nxënësit fitojnë njohuri për mënyrën si njerëzit organizojnë prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave e të shërbimeve dhe njihen e kuptojnë çështjet themelore, që lidhen me vendimet në fushën e veprimtarisë ekonomike. Ata njihen në përputhje me nivelin e shkollimit dhe të kurrikulës, me konceptet kryesore ekonomike dhe rëndësinë që ka njohja e tyre për jetën e tij dhe të shoqërisë. Në këtë mënyrë, mundësohet edhe reazimi i kompetencës ekonomike, që nënkupton njohuri për funksionimin e botës ekonomike dhe aftësi për të vepruar me mençuri në këtë botë.</p>		
<p><b>Rezultatet e të nxënit</b>  <b>Është biznesi im</b>  <b>9 orë</b></p>		
<p><b>Njohuritë</b></p>	<p><b>Shkathtësitë dhe aftësitë</b></p>	<p><b>Qëndrimet dhe vlerat</b></p>
<p>Duke punuar në grup, nxënësi fillon të identifikojë karakteristikat sipërmarrëse që ai zotëron, duke mësuar për jetët e sipërmarrësve të shquar të së kaluarës dhe sot</p> <p>Nxënësi punon në grup për të për të plotësuar një material për klubin rinor. Ai identifikon karakteristikën e parë të sipërmarrësit dhe plotësojnë formularin e nevojave të konsumatorit. Nxënësi fillon të dallojë aftësitë dhe njohuritë që duhen për të filluar një biznes.</p> <p>Duke punuar në grup, nxënësi njihet me karakteristikën e dytë të sipërmarrësit, “njih</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përkufizon sipërmarrjen;</li> <li>• dallon karakteristika kryesore të sipërmarrjes;</li> <li>• dallon karakteristikat sipërmarrëse vetjake;</li> <li>• përshkruan se si sipërmarrësit plotësojnë një nevojë të tregut;</li> <li>• diskuton për rolin e njohjes së tregut në përcaktimin e nevojave të tij dhe për të fituar avantazh konkurrues;</li> <li>• krijon reklama të efektshme për disa biznese;</li> </ul>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• beson te aftësitë e tij;</li> <li>• krijon dhe shpall profilin e tij sipërmarrës.</li> </ul>

<p>konsumatorin tënd dhe produktin”.</p> <p>Nxënësi zbulon rrugë të ndryshme për të tregtuar produkte të veçantë për konsumatorë të veçantë.</p> <p>Nxënësi merr pjesë në një panair shitjeje të projektuar për të nxjerrë në pah sipërmarrësit krijues dhe novator dhe bizneset e tyre.</p> <p>Duke analizuar modele aktuale sipërmarrësish, nxënësi identifikon bizneset që mund të fillojë.</p> <p>Ai shqyrton rrugët që sipërmarrësit përdorin karakteristikën e katërt të sipërmarrjes për të zhvilluar planin e tyre të biznesit.</p> <p>Nxënësi krijon karta të profilit të sipërmarrësit për të treguar shkallën në të cilën ai kupton karakteristikën e katërt të sipërmarrësit: ‘Beso te vetja’</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• tregon se të qenit krijues dhe novator janë aftësi të domosdoshme të sipërmarrëse për të filluar një biznes;</li> <li>• mbron me argumente vendimet e tij;</li> <li>• analizon si sipërmarrësit përdorin njohuritë dhe aftësitë e tyre për të ndërtuar një biznes;</li> <li>• zhvillon një plan biznesi.</li> <li>• krijon një profil vetjak sipërmarrësi.</li> </ul>	
---	--	--

#### 4. UDHËZIME METODOLOGJIKE

Përmbajtja e lëndës së qytetarisë ofron mundësi të shumta që mësuesit të zhvillojnë orë mësimore bazuar në :

- ndërveprimin aktiv midis mësuesit dhe nxënësve,
- shfrytëzimin e përvojave personale të nxënësve
- pjesëmarrjen efektive të nxënësve në veprimtaritë mësimore
- pavarësinë e nxënësve në shprehjen e lirë të ideve dhe opinioneve vetjake
- përdorimin e mjeteve didaktike të domosdoshme për zhvillimin normal të programit.

Ky edukim arrihet nëpërmjet përdorimit të metodave, teknikave dhe strategjive ndërvepruese që krijojnë një bashkëpunim harmonik midis mësimdhënies dhe të nxënësve, ku ndërthuren lloje të ndryshme të edukimit, të tilla si: edukimi i të drejtave të njeriut, edukimi ndërkulturor, edukimi për paqe, edukimi global, edukimit nëpërmjet medias, edukimi mjedisor, edukimi rrugor, edukimi ekonomik etj.

Programi kësaj lënde është element i një kurrikule të hapur të formimit qytetar dhe si e tillë ajo nuk i pranon lehtë format tradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënësve, kur roli i mësuesit është thjesht transmetues i dijeve, kurse fëmija një dëgjues pasiv. Të kundërtën synon ky program. Ai motivon një ndërveprim të efektshëm midis nxënësve dhe mësuesit, midis punës në grupe të vogla dhe të mëdha, midis punës së pavarur dhe asaj individuale, por përparësi duhet të marrë stimulimi i ideve të ndryshme, të shumta të dala nga nxënësit, reflektimi kritik i tyre ndaj koncepteve të përmbajtjes lëndore. Një element i një rëndësie të veçantë konsiderohen produktet e veprimtarive që mund të përgatiten nga nxënësit në klasë, si postera, struktura të ndryshme mendore në letra të bardha, gazeta të ndryshme ose reflektime të shkruara për çështje të ndryshme. Produktiviteti i nxënësve shihet si një tregues cilësor i zbatimit të këtij programi.

Pretendimet e kësaj lënde janë të mëdha. Përmbajtja e saj del jashtë kufijve të orës mësimore, të strukturave tradicionale të shkollës. Ajo thyen “disiplinën” mësimore në klasat tona. Ajo kërkon debat, gjallëri, mbajtje qëndrimesh, opinione të ndryshme, këndvështrime të shumëllojshme nga ana e fëmijëve, gjë që nuk është e lehtë, pasi kjo lidhet me formimin gjuhësor, shkencor dhe aftësitë personale të fëmijëve, të cilën ua mundësojnë edhe lëndë të tjera të kurrikulës së këtij cikli shkollimi. Në këtë kontekst lënda e qytetarisë ndërthur dhe integron natyrshëm shumë njohuri të fituara në lëndë të tjera.

Një aspekt tjetër i shtjellit të kësaj lënde është përdorimi i përvojave personale, i ngjarjeve të ndryshme të komunitetit ku ata bëjnë pjesë, si raste studimi për shumë tema mësimore dhe objektiva që synon të pëmbushë kjo lëndë. Në këtë kuptim “rastet e studimit” nga komuniteti shërbejnë si ura lidhëse midis formimit të nxënësve në shkollë dhe jetën reale që përballojnë, por efektiviteti i kësaj mënyre të vepruarit reflektohet natyrshëm në qëndrimet që nxënësi do të mbajë konkretisht brenda grupit shoqëror, të cilit i përket.



Mësuesit përdorin dhe zhvillojnë në mësimdhëniet e tyre modele të ndryshme të saj, por ky program kërkon së pari planifikimin dhe zhvillimin e mësimdhënies ndërvepruese, që ka në themel bashkëveprimin mësues-nxënës, mjedis fizik, materiale didaktike, personale të mësuesit dhe nxënësit, si dhe produkte të shumta të hartuara dhe përgatitura nga vetë fëmi nxënësit, ku puna në grupe është e rëndësishme, por e shoqëruar patjetër me punën e pavarur dhe atë individuale.

### **Çfarë kërkohet nga mësuesi i lëndës së qytetarisë?**

Rolet dhe kompetencat që mësuesit dhe nxënësit kanë pasur tradicionalisht, sot kanë pësuar ndryshime. Disa nga ndryshimet që kanë ndodhur në kompetencat tradicionale të mësuesve lidhen me:

- *dijet e integruara ndërlëndore përkundrejt dijeve të kufizuara në kuadrin e lëndëve të veçanta* në: lëndët mësimore; teoritë dhe çështjet që lidhen me natyrën dhe zhvillimin njerëzor; përshtatjen e teorive të ndryshme të të mësuarit për arritjen e synimeve të veçanta edukative; (në fushën e sjelljes, të njohurive dhe të humanizmit); parimet e procesit të mësimdhënies/ të të nxënës; organizimin dhe administrimin e veprimtarive në grup;
- *procesin e shumëfishtë dhe dinamik të mësimdhënies përkundrejt procesit linear dhe statik të saj*, në të gjitha përmasat e tij: a) në përpunimin dhe përcaktimin e objektivave të larmishëm; b) në administrimin elastik të orëve të mësimit dhe të grupeve; c) në shumëllojshmërinë e modeleve të mësimdhënies përmes të mësuarit të hapur dhe në bashkëpunim; d) në vlerësimin e ndërsjellë;
- *synimet edukative të shumëfishta përkundrejt atyre të kufizuara në fushën e njohurive. Të parat marrin parasysh kompleksitetin dhe ndryshimet që ndodhin në botën e sotme dhe mbështeten në angazhimin individual për të përmirësuar kushtet e jetës dhe për të zotëruar shprehitë e nevojshme për veprim.*

Një prej kërkesave më të rëndësishme në fushën e mësimdhënies është bindja e mësuesit në aftësinë e nxënësve për të mësuar dhe që ai vetë është i aftë t'i mësojë ose t'i ndihmojë për të mësuar. Të mësuarit për qytetarinë demokratike përfshin edhe aftësi të tjera të mësimdhënies që janë të rëndësishme për procesin e aftësimin të nxënësve për t'u bërë qytetarë të përgjegjshëm:

- aftësia për t'i parë problemet nga këndvështrimi i nxënësit, duke marrë parasysh prejardhjen, moshën dhe nivelin e tij arsimor, si dhe aftësia për të mos paragjykuar qëndrimet dhe perceptimet që janë të ndryshme nga të tija;
- aftësia për të kuptuar, pranuar dhe respektuar ngjashmëritë dhe ndryshimet që ekzistojnë ndërmjet mësuesve dhe nxënësve si dhe ndërmjet nxënësve;
- respektimi i të drejtave të nxënësve dhe ndjeshmëria ndaj nevojave dhe interesave të tyre;
- aftësia për të trajtuar çështje të diskutueshme dhe për t'u përballuar me situata problematike dhe komplekse që mund të ndeshen në mjedisin shkollor;
- aftësia për ta parë veten dhe nxënësin si pjesëmarrës aktiv në komunitetin lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar;
- bindja në mundësinë e progresit dhe që çdo individ mund të ndihmojë në arritjen e tij;

- aftësia për të integruar përparësitë vetjake në një kuadër të përbashkët problemesh e vlerash dhe për të zbatuar në praktikë vendimet e marra nga nxënësi;
- gatishmëria për të pranuar gabimet para grupit dhe për të nxjerrë mësim prej tyre;
- aftësia për të shtruar dhe debatuar haptazi për probleme të diktuar nga kurrikula e fshehtë.

### **Mjedisi i të nxënit të qytetarisë demokratike**

Edukimi për qytetari demokratike nxit dhe nxitet nga një mjedis të nxëni demokratik në shkollë dhe nga një metodë që synon të përfshijë të gjithë shkollën, nga metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit dhe nga pjesëmarrja e nxënësve, e stafit arsimor, e prindërve në marrjen e vendimit dhe sa më shumë të jetë e mundur në kurrikulën e arsimit formal dhe joformal.

Ai kërkon që nxënësit të njihen dhe të pranohen si subjekte të drejtash, nga njëra anë, dhe si bartës të drejtash, nga ana tjetër.

Edukimi për qytetari demokratike zgjerohet dhe mbështetet nga bashkëveprimi krijues ndërmjet institucioneve arsimore dhe të komunitetit, duke nënkuptuar edhe bashkëveprimin ndërmjet të nxënit formal dhe joformal. Si i tillë ai kërkon mbështetjen e duhur ligjore dhe financiare për zhvillime autonome në të gjitha nivelet.

Edukimi për qytetari demokratike duhet të zhvillohet duke vendosur partneritete ndërmjet aktorëve në edukimin për qytetari demokratike, duke vlerësuar pozitivisht kulturat dhe mënyrën e jetesës demokratike të rinisë dhe në vetëshprehjen dhe aspiratat e nxënësve dhe e të rinjve për t'u dëgjuar, duke e shndërruar këtë në bazë të edukimit për qytetari demokratike; duke ndërmarrë kërkime që kanë në bazë pjesëmarrjen dhe zbatimin në praktikë të nismave dhe risive në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për trajnimin dhe zhvillimin e kurrikulave; duke nxitur informacionin për përdorimin e teknologjive të komunikimit në fushën e arsimit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vlerësimit përzgjedhës me kritereve të informacionit dhe mbështetjes së nismave e të të drejtës për të shfrytëzuar ICT në fushën e edukimit për qytetari demokratike; duke zhvilluar vetëdijen dhe praktikën e mishërimit të përgjegjësishë shoqërore;

### **Nxënësit me nevoja të veçanta**

Programi i lëndës së qytetarisë duhet t'u krijojë mësuesve hapësirat për të përshtatur mësimdhënien sipas nevojave të veçanta të nxënësve dhe për të personalizuar të nxënët e tyre. Mësuesit duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit janë të ndryshëm, kanë motive, interesa, stile të nxëni, nevoja dhe aftësi të ndryshme etj. dhe të zhvillojnë mësimin në mënyrë të tillë që përputhet me stilet e të nxënët të nxënësve, veçanërisht të atyre me nevoja të veçanta.

#### *a) Nxënësit me vështirësi në të nxënë*

Shumë nxënës me vështirësi arrijnë rezultatet e pritshme të të nxënët njësoj si nxënësit e tjerë, nëse bëhen përshtatje në mënyrën e mësimdhënies dhe të vlerësimit të tyre.

Për të arritur nivelin më të lartë të mundshëm të realizimit të rezultateve të pritshme të të nxënët, mund të zhvillohen programe të veçanta, individuale, për nxënësit me nevoja të veçanta.

Në rastin e nxënësve që formalisht janë përcaktuar si të veçantë, është veçanërisht e rëndësishme që stafi i shkollës, në bashkëpunim me prindërit, të mbështesë të nxënët e tyre. Procedurat dhe teknikat e vlerësimit për nxënës me nevoja të veçanta duhet të diskutohen herë pas here me prindërit dhe vetë nxënësit. Prindërit duhet të kuptojnë se si ndikojnë këto procedura dhe teknika të përshtatura në vlerësimin e punës së nxënësve.

#### *b) Nxënësit e talentuar*

Fleksibiliteti i zhvillimit të programit lejon plotësimin e nevojave individuale të nxënësve të talentuar.

Mësuesit duhet t'u krijojnë kushte dhe situata të tilla që nxënësit të shfaqin dhe të zhvillojnë talentet e tyre. Kjo arrihet nëse atyre u krijohen mundësitë të punojnë me një përmbajtje më të thelluar dhe zgjeruar, të zgjerojnë mjediset dhe materialet e të nxënët brenda dhe jashtë shkollës.

## 5. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN

Standardet e përmbajtjes së lëndës së qytetarisë përfshijnë tri elemente të ndërlidhura me njëri-tjetrin: njohuritë, aftësitë intelektuale e të pjesëmarrjes dhe prirjet qytetare. Të marra së bashku këto elemente përbëjnë bazën për zhvillimin e edukimit qytetar dhe për rrjedhojë edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve të pasqyrojë nevojën për të vlerësuar shkallën e përvetësimit të këtyre tri elementeve nga nxënësit.

**Njohuritë** përbëjnë thelbin e sistemit të vlerësimit dhe në përgjithësi mishërohen, për shembull, në pyetjet të tilla, si:

- Cili është thelbi i qytetarisë dhe i jetës qytetare në demokraci?
- Cilat janë bazat mbi të cilat ngrihet sistemi demokratik në vend?
- Si dhe në çfarë shkalle sistemi politik në vend bazohet në qëllimet, vlerat dhe parimet e demokracisë të pranuar gjerësisht nga shoqëria jonë?
- Cili është roli i qytetarit në demokraci? etj.

**Aftësitë intelektuale e pjesëmarrëse** të edukimit qytetar përfshijnë përdorimin e njohurive për të menduar në mënyrë kritike dhe krijuese dhe për të vepruar me efektshmëri e në mënyrë të arsyeshme për të përballuar e për të zgjidhur sfidat e jetës demokratike në vend.

**Aftësitë intelektuale** i aftësojnë nxënësit të mësojnë dhe të zbatojnë njohuritë qytetare në funksionet e shumta dhe të ndryshme të qytetarit. Këto aftësi i ndihmojnë qytetarët të identifikojnë, të përshkruajnë, të shpjegojnë dhe të analizojnë informacionin dhe argumentet, si dhe të vlerësojnë, të marrin dhe të mbrojnë qëndrime të caktuar për çështje të jetës publike.

**Aftësitë pjesëmarrëse** i përgatisin qytetarët të monitorojnë dhe të ndikojnë jetën publike dhe qytetare, duke bashkëpunuar me të tjerët, duke formuluar dhe duke shprehur qartë idetë dhe interesat e tyre, duke bërë koalicione, duke kërkuar mirëkuptim, duke bërë marrëveshje dhe duke menaxhuar konfliktet.

Një të rëndësishëm në lëndën e edukimit qytetar nënkupton edhe vlerësimi, në atë shkallë që është e mundshme, të aftësive pjesëmarrëse. Kjo do të thotë se testimi duhet të përfshijë *edhe matjen e shkallës në të cilën nxënësit kuptojnë* përdorimin e duhur të aftësive pjesëmarrëse. Këtu duhet të sqarojmë se në këtë vlerësim nuk përfshihet matja e drejtpërdrejtë e aftësive pjesëmarrëse të nxënësve, për shembull, në qeverinë e nxënësve në shkollë ose në veprimtari të tjera publike.

Elementi i tretë janë prirjet qytetare që përshkojnë të gjitha aspektet e qytetarisë. Në një sistem demokratik ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe me përgjegjësitë e individëve në shoqëri dhe me çuarjen përpara të idealeve të qeverisjes demokratike.

Këtu përfshihen prirjet:

- për të qenë një anëtar i pavarur i shoqërisë,
- për të respektuar vlerat vetjake dhe dinjitetin njerëzor,
- për të marrë përsipër përgjegjësitë vetjake, politike dhe ekonomike të qytetarit,
- për t'iu bindur “rregullave të lojës”, si: pranimi i vendimit të ligjshëm të shumicës dhe respektimit të të drejtave të pakicave,
- për të marrë pjesë në çështjet qytetare në mënyrë të mirëinformuar, të arsyeshme dhe të efekshme,
- për të nxitur dhe për të mbështetur funksionimin e shëndetshëm të demokracisë në vend.

Vlerësimi i prirjeve qytetare të nxënësve të përqendrohet në pyetje që kanë të bëjnë me njohjen e rëndësisë që kanë këto prirje për demokracinë. **Vlerësimi në asnjë mënyrë nuk duhet të përfshijë pyetje që kanë të bëjnë me vlerat dhe prirjet vetjake të nxënësve të vlerësuar.**

Për këtë arsye, pyetjet që lidhen me prirjet qytetare të lidhen me njohuritë dhe aftësitë intelektuale. Për shembull, nxënësit mund t'i kërkohej të përshkruajë rëndësinë e dëgjimit me respekt të mendimeve dhe opinionëve të tjerëve. Po kështu, nxënësve mund t'u matet aftësia për të vëzhguar dhe për të zbuluar shkallën e përputhjes së veprimtarisë së qeveritarëve ose të institucioneve qeverisëse më parimet kushtetuese.

Fitimi i njohurive, i aftësive dhe zhvillimi i prirjeve qytetare realizohen në kushte të ndryshme, si: shtëpi, shkollë, bashkësi, shtet, rajon e më gjerë. Të gjitha këto përbëjnë edhe fushat kryesore në të cilat jo vetëm fitohen njohuritë dhe aftësitë, por edhe zbatohen ato në praktikë.

## **6. MATERIALET DHE BURIMET MËSIMORE**

Përdorimi i mjeteve mësimore në mësimdhënien dhe procesin e të nxënit në fushën “Shoqëria dhe mjedisi” ndihmon në konkretizimin e ideve dhe dukurive, në aplikimin e metodave dhe strategjive të mësimdhënies, si dhe e bën mësimin më interesant dhe më argëtues për nxënësin. Përdorimi i suksesshëm i metodave dhe i teknikave të lartpërmendura, nuk mund të realizohet pa mjetet e nevojshme didaktike, të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme, si: harta të përgjithshme ose tematike, atlase, albume, foto, skica, filma mësimorë, videokaseta, kompjuter, aparat projektimi, CD, DVD etj.

Ndërsa mësuesi është përgjegjës për krijimin e një mjedisi stimulues, ai duhet të sigurojë që nxënësi të ketë akses në burimet e ndryshme të të nxënit. Lista e burimeve të vlefshme për zhvillimin e kompetencave në gjeografi është e larmishme: muzeume, objekte të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, harta, plane, piktura, dokumente historike, dokumente audio-vizivë, etj. Gjithashtu burimet përfshijnë teknologjitë e informacionit dhe komunikimit që nxënësit i përdorin si mjete kërkimi dhe për përgatitjen e projekteve dhe detyrave të ndryshme.

### **Sugjerime për përdorimin e TIK**

- Përdorimi i postës elektronike për shkëmbim informacioni
- Përdorimi i internetit për të shfrytëzuar faqet Web për njohuri per shoqerine.
- Përdorimi i CD-ROM për mbledhjen e informacionit mbi temat që ai/ajo studion.
- Organizimi dhe prezantimi i të dhënave duke përdorur tipa të ndryshëm softëare
- Përdorimi i simulimeve software
- Përdorimi i grafikëve software
- Paraqitja grafike e të dhënave